

NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

PËR PROJEKTVENDIMIN

“PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR SIGURINË KIBERNETIKE 2025-2030 DHE PLANIT TË SAJ TË VEPRIMIT 2025-2027”

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK), në përmbushje të misionit të tij për të garantuar një mjedis të sigurt kibernetik në Republikën e Shqipërisë, ka hartuar Strategjinë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe Planin e Veprimit për periudhën 2025 - 2030.

Ky dokument përfaqëson një vizion të qartë për të ardhmen e sigurisë kibernetike në vend, dhe synon të përforcojë kapacitetet institucionale, ndërgjegjësimin publik, dhe bashkëpunimin ndërkombëtar përballë sfidave në që lidhen me kërcënimet dhe rreziqet në mjedisin digjital.

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike fton qytetarë, organizata të shoqërisë civile, ekspertë të fushës, shoqata dhe përfaqësues të tjerë të publikut të interesuar për të kontribuar përgjatë procesit të konsultimit publik për projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2025-2030 dhe Planit të saj të Veprimit 2025-2027”.

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike mirëpret komentet dhe propozimet tuaja mbi:

- Objektivat strategjike të dokumentit dhe rezultatet e pritshme për sigurinë kibernetike në Shqipëri;
- Përputhshmërinë me legjislacionin kombëtar dhe direktivat e BE-së;
- Rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar në fushën e sigurisë kibernetike;
- Zhvillimin e kapaciteteve, ndërgjegjësimin dhe përfshirjen e grupeve të interesit në zbatimin e masave të strategjisë.

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike do të përmbledhë të gjitha sugjerimet dhe komentet tuaja dhe do të japë sqarime për mënyrën se si ato janë reflektuar, edhe në rast se mendimet nuk reflektohen.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimi publik do të zgjasë 20 ditë pune, nga data 29/05/2025 deri më 26/06/2025.

Si të përgjigjeni:

Mund të merrni pjesë në procesin e konsultimeve publike duke dërguar komentet dhe sugjerimet tuaja në:

- Formularin online në Regjistrin Elektronik të Konsultimeve Publike:
<http://www.konsultimipublik.gov.al>;
- Email në adresën zyrtare të koordinatorit për konsultimin publik: info@aksk.gov.al

Kontakti:

Të dhënat e kontaktit të koordinatorit përkatës për konsultime publike dhe/ose të ndonjë personi tjetër të cilit i drejtohen pyetjet:

Anisa Verushi

Specialist

Sektori i Koordinimit të Projekteve Ndërkombëtare, Zhvillimit Strategjik dhe Identifikimit

Drejtoria e Koordinimit të Projekteve Ndërkombëtare dhe Zhvillimit Strategjik të Sigurisë

Kibernetike

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike

Datat dhe vendet e takimeve publike:

Me Urdhërin e Kryeministrit nr. 200, datë 10.10.2024, “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2025 - 2030 dhe Planit të saj të Veprimit 2025 - 2027”, u ngrit një mekanizëm ndërinstitucional për të garantuar një proces gjithëpërfshirës dhe të koordinuar.

Në kuadër të këtij procesi, janë zhvilluar gjithsej katër takime zyrtare me pjesëmarrjen aktive të përfaqësuesve nga të gjitha institucionet përkatëse. Gjatë këtyre takimeve është bërë një analizë e thelluar e situatës aktuale të sigurisë kibernetike në vend, janë identifikuar masat e pazbatuara nga strategjia e mëparshme dhe është diskutuar mbi elementët e rinj që do të përfshihen në dokumentet strategjike të reja, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe përputhshmërinë dhe standardet ndërkombëtare.

Sfondi i propozimit legjislativ

Projektakti i propozuar ka për qëllim miratimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2025-2030 dhe Planit të saj të Veprimit 2025-2027”.

Strategjia synon forcimin e qëndrueshmërisë digjitale të vendit përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse ndaj sigurisë kibernetike, përmirësimit të kuadrit ligjor dhe institucional,

rritjes së kapaciteteve profesionale, inovacionit teknologjik, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe përfshirjes së shoqërisë në tërësi në këtë proces.

Propozimet

Projektakti vjen si vijimësi e proceseve të nisura me Strategjinë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2020 - 2025 dhe si domosdoshmëri për përmirësimin e mëtejshëm të politikave në këtë fushë, përmes adresimit të mangësive të identifikuara dhe rritjes së efektivitetit të masave mbrojtëse kundër kërcënimeve kibernetike në rritje.

Miratimi i kësaj Strategjie vjen edhe si pjesë e detyrimeve kombëtare me qëllim për përputhshmërinë me normat dhe direktivat e Bashkimit Evropian dhe forcimin e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë për të adresuar kërcënimet e sofistikuara dhe ato hibride që mund të çenojnë sigurinë kombëtare dhe stabilitetin digjital të vendit.

Një element kyç i strategjisë është forcimi i mekanizmave të koordinimit ndërinstytucional dhe përcaktimi i qartë i roleve dhe përgjegjësive të institucioneve përgjegjëse për sigurinë kibernetike. Edhe pse janë hedhur hapa të rëndësishëm në këtë drejtim, mbetet sfida përmirësimi i mëtejshëm i bashkëpunimit dhe cilësisë së ndërveprimit institucional. Në këtë kontekst, roli udhëheqës i Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike është thelbësor për zbatimin efektiv të kësaj strategjie në nivel kombëtar.

Pyetjet

Jeni të ftuar të jepni komentet dhe kontributet tuaja për të gjitha aspektet e propozuara. Për më tepër, ne kemi zgjedhur pyetjet e mëposhtme ku kontributi juaj do të jetë veçanërisht i vlefshëm, dhe të cilave mund t'i përgjigjeni duke plotësuar një pyetësor të shkurtër në internet.

- Si mendoni se mund të ndikojë kjo strategji në përmirësimin e sigurisë digjitale për qytetarët, institucionet dhe sektorin privat në Shqipëri?
- A është gjithëpërfshirës ky dokument strategjik në drejtim të forcimit të bashkëpunimit ndërinstytucional dhe përfshirjes së aktorëve kyç në fushën e sigurisë kibernetike?
- Cilat janë sugjerimet tuaja për përmirësimin e masave të ndërgjegjësimit publik dhe edukimit mbi sigurinë kibernetike në Strategji?